

VENDIM
Nr.170, datë 29.3.2006

**PËR NGJYROSJEN E LËNDËS DJEGËSE PËR AUTOMJETET ME MOTOR DIESEL, SI
DHE TË LËNDËS DJEGËSE, QË IMPORTOHET PËR QËLLIME INDUSTRIALE
E PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 17 të ligjit nr.8464, datë 11.3.1999 “Për standardizimin”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lënda djegëse për automjetet me motor diesel, gazoil, (prodhim vendi), sipas STASH 31:1997, që do të përdoret për nevoja të bujqësisë dhe të peshkimit, të denatyrohet, duke u ngjyrosur me ngjyrë jeshile.

2. Ngjyrosja e gazoilit të prodhuar në vend realizohet nga shoqëria “ARMO” sh.a., përpara se lënda të hidhet në treg, sipas destinacioneve përkatëse.

3. Lënda djegëse, që importohet për qëllime industriale dhe publike, me emërtimin “Heating Oil”, të importohet dhe të tregtohet e ngjyrosur, me ngjyrë të kuqe.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha